



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:281536

Datë: 20.06.2022

Numri i dokumentit: 03149452

P.nr.1/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësen Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit Z.A nga Hani i Elezit, i akuzuar për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.224/2021 të datës 15.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, publik më datë 06.06.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit Paulin Pashku dhe të pandehurit, mbrojtësit të të pandehurit Avokat Qamush Brava, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 20.06.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: Z.A nga Hani i Elezit Rr. ‘...’, i lindur më datë ..., nga i ati N... dhe e ëma B..., e gjinisë A..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, punon në ndërtim, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i gjykuar edhe më parë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 12.11.2021, rreth orës 22:00, në qytetin e Hanit të Elezit, përkatësisht ne Lagjen e Bushëve, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë apo preparate, të cilat me ligj janë

shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që me rastin e ndaljes dhe kontrollit nga ana e policisë, tek i njëjti, janë gjetur dhe sekuestruar katër qese dhe një gjysmë cigare me substancë të narkotike të llojit marihuanë, në sasi prej 2.18 gram.

- Me të cilin veprim ka kryer veprën penale: Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 17, 38, 39, 43, 47, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 453 të KPPK-së e:

DËNIM ME GJOBË

I. Dënim me gjobë në shumë prej 300€ (Treqind) euro, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në 3 këste të barabarta, në afat prej 3 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II. Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me sasi prej 2.18 gram.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20.00€ € dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.224/21 të datës 15.12.2021, kundër të pandehurit të lartë cekur për shkak të veprës penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve,

substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurin të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 06.06.2022.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për veprën penale për të cilën akuzohet, ka deklaruar se është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë më vepra penale në të ardhmen.

Mbrojtësi i pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi im është konsultuar me mua për pranimin e fajësisë, është i njoftuar për beneficionet dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë, i propozojë gjykatës që me rastin e matjes së dënimit ti ketë parasysh këto rrethana lehtësuese, si pranimi i fajësisë është për të parën herë për veprën penale të natyrës së tij, fajësinë e ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës dhe ka premtuar se nuk do të përsëris vepra të tilla në të ardhmen, dhe kërkon nga gjykata që ti shqiptojë një dënim sa më të lehtë për arsye se është në pritje të rregullimit të dokumentacionit për në Norvegji.

Prokurorja e Shtetit duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, ngase e njëjta është bërë konform nenit 248 të KPPRK-së dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqiptojë dënim sipas ligjit.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht; Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehurit e ka pranuar fajësinë, rrethanë lehtësuese se është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tjera penale. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Në mbështetje të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së është konfiskuar në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me sasi prej 2.18 gram.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.1/22 datë 20.06.2022

Procesmbajtësja:

Suzane Rudi

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.